# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL-QERSHOR 2026

| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 02.04.2026 | Kërkesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit zyrtar që lidhet me çdo objektet të shpallur "Monument Kulture" në qytetin e Kavajës.<br>Konkretisht:<br>· Kopje të vendimeve zyrtare për shpalljen e secilit objekt si "Monument Kulture";<br>· Dosjet përkatëse për çdo objekt, të cilat përmbajnë të dhëna mbi historikun, vlerat arkitektonike dhe kulturore, gjendjen aktuale, si dhe çdo dokumentacion shoqërues (fotografik, hartografik, etj.) | 09.04.2026 | Ne vijim te kerkeses suaj, ju vendosim ne dispozicion materialin qe disponojme rreth objekteve ne Kavaje.<br><br>https://www.transferxl.com/it/download/08vQFNb5C4WNDs - Ura e Bukaqit mbi vijen e Fokes, Kavaje<br><br>https://www.transferxl.com/it/download/08j9NJ6HCF8T8C - Banesa e Haxhialusheve, Kavaje<br><br>https://www.transferxl.com/it/download/08jVsJ2QN3sj6L - Banesa Rrahim Domi, Kavaje<br><br>https://www.transferxl.com/download/0821Y53QqWzqz - Kulla e Sahatit, Kavaje<br><br>https://www.transferxl.com/download/08gbCgxZk6Mw4 - Muzeu Etnografik, Kavaje<br><br>https://www.transferxl.com/download/082HCLTtRFbtY - Vendimet e shpalljeve nder vite | E plotë | 2000 |
| 2 | 06.04.2026 | Kwrkesw pwr paketwn e plotw tw projektit: projekti "*Restaurimi i banesës Haxhistasa, lagjja Kala, Berat, me kod K – 089*", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë | 17.04.2026 | Ne mbledhjen e KKTKM date 27.03.2026 u shqyrtuar dhe miratua projekti "*Restaurimi i banesës Haxhistasa, lagjja Kala, Berat, me kod K – 089*", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)",** me vendim nr. 96.<br>Bashkëlidhur ne link gjeni paketen e plote te projektit te miratuar dhe te sigluar nga sekretari i KKTKM.<br><br>Link - https://mab.to/t/7X4r39UEeIG/eu1 | E plotë | Jo |
| 3 | 10.04.2026 | Kerkese per informacion per fond restaurimi | 10.04.2026 | Ne përgjigje te kërkesës suaj ju bëjmë me dije se Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nuk është institucioni përgjegjës për ofrimin e fondeve te restaurimit. | E plotë | jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Lutemi qe kërkesën tuaj ta drejtoni pranë Ministrisë se Turizmit, Kulturës dhe Sportit ne adresën elektronike infomacion@mtks.gov.al | | |
| 4 | 10.04.2026 | Kerkese per informacion/dokumentacion per objeketet: Kalanë e Këlcyrës dhe Sarajet e Ali Bej Këlcyrës | 12.05.2026 (pas pageses se fatures per arketim) | Në vijim të kryerjes se pageses dhe dergimit te mandat pageses ne format elektronik, në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 27.08.2025 “Për miratimin e tarifave dhe mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”<br>ju dërgojmë bashkëlidhur në link kopje digjitale te materialeve arkivore fotografike për Kalane dhe Sarajet e Ali bej Kelcyres.<br>https://www.transferxl.com/it/download/08vtQsscRcRfTr | E plotë | 2000 |
| 5 | 10.04.2026 | Informacion mbi vlerfshmerine e vendimit te KKTKM | 17.04.2026 | Ne vijim te kërkesës se paraqitur, dhe bazuar ne legjislacionin ne fuqi, me konkretisht ligji 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" neni 79, pika 7 citohet:<br><br>***7. Afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më shumë se 1 vit, nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga KKTKM-ja.***<br>Bazuar ne dokumentacionin e përcjellë nga qytetari, rezulton se vendimi i KKTKM është date 23.08.2024 dhe leja e ndërtimit e lëshuar nga Bashkia Berat është date 01.09.2025.<br>Sa me sipër, sipas legjislacionin ne fuqi vërehet se është tejkaluar afati 1 vjeçar i vendimit te KKTKM dhe gjithashtu kërkesa përcillet 7 muaj pas nxjerrjes se lejes nga Bashkia Berat.<br>Ne këto kushte, te respektohet dispozita e nenit 79, pika 7 | E plotë | Jo |
| 6 | 20.04.2026 | Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit teknik dhe materialeve fotografike për kullat e zonës së Matit. | 21.04.2026 | Ne vijim të kërkesës suaj të paraqitur në adresën elektronike të IKTK-së, dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 27.08.2025 “Për miratimin e tarifave dhe mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore” (pika 5),<br>dërgojmë bashkëlidhur, nëpërmjet linkut përkatës, kopje digjitale të dokumentacionit grafik, fotografik dhe përshkrimor të | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | banesave-kulla të zonës së Matit, të grupuara në folderë sipas emërtimeve përkatëse të kullave. https://www.transferxl.com/it/download/08jCkMVwSfPgbL | | |
| | 21.04.2026 | Kerkese per informacion/dokumentacion mbi nje object te ndodhur ne pazarin e vjeter te Krujes | 29.04.2026 | Ne vijim të kryerjes se pageses dhe dergimit te mandat pageses, në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 27.08.2025 "Për miratimin e tarifave dhe mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore" dërgojmë bashkëlidhur në link kopje digjitale te materialeve arkivore rilevimet e vjetra arkitektonike si dhe planimetri per Pazarin e Krujës. ps://www.transferxl.com/it/download/08jrB6sm1Z7X9Q | E plotë | 20000 |
| 7 | 22.04.2026 | Kerkese per venien ne dispozicion te materialeve arkivore qe dispononi per pasurine kulturore "Banesa e Abdulla Krajes". | 27.04.2026 | Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar në adresën elektronike të IKTK-së, dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 27.08.2025 "Për miratimin e tarifave dhe mënyrën e përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore" (pika 5), ju përcjellim bashkëlidhur, nëpërmjet linkut përkatës, kopje digjitale të dokumentacionit arkivor per objektin "Banesa e Abdulla dhe Muho Krajës", Shkodër si me poshte:<br>• **Dokumentacioni fotografik**<br>(Fotografite me nr. 12.790 janë realizuar në vitin 1972 nga Fatbardha Shkupi, ndërsa fotoja me nr. 13.789 eshte realizuar në vitin 1973 nga H. Çollaku);<br>• **Dokumentacioni grafik i ornamentikes.**<br>https://www.transferxl.com/it/download/08vYq4Rj8T8xDN<br>https://www.transferxl.com/it/download/08NTkjw22nRm7 | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 27.04.2026 | Informacion mbi fazën aktuale të procedurës së shqyrtimit te aplikimit per licence per veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore | 27.04.2026 | Bashkëlidhur lutem gjeni përgjigjen ne vijim te kërkesës për informacion mbi statusin e aplikimit për licence<br>281 prot date 27.04.2026_Kthim pe | E plotë | Jo |
| 9 | 05.05.2026 | Kërkesë për marrje dokumentacioni | 08.05.2026 | Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 30.03.2026 administruar në Sekretarinë Teknike të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK) me nr. 137/1 Prot., datë 01/04/2025 "*Kërkesë për marrje dokumentacioni*", me anë të së cilës kërkoni t'ju vihen në dispozicion procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, regjistrimet audio dhe projekt-aktet përkatëse lidhur me Vendimet nr. 565, datë 20.11.2025 dhe nr. 650, datë 30.12.2025 mbi *"Ndërhyrjet restauruese në fasadën e objektit "Hotel Internacional", Monument Kulture i Kategorisë së II-të"*, të cilat e keni kërkuar dhe më parë nëpërmjet postës elektronike drejtuar info@iktk.gov.al më datë 21.03.2026 dhe në vijim në datat 27.04.2026, 04.05.2026 dhe 05.05.2026, Ju bëjmë me dije si vijon:<br>Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit objekt kërkimi, rezulton se procesverbalet, regjistrimet audio dhe projektaktet e mbledhjeve të KKTKM-së përbëjnë dokumente të brendshme pune dhe akte përgatitore administrative, të krijuara në funksion të procesit deliberativ dhe vendimmarrës të organit kolegjial.<br>Referuar nenit 17, pika 2, shkronja "e" të Ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, e drejta e informimit kufizohet në rastet kur dhënia e informacionit shkakton dëm të qartë dhe të rëndë ndaj procesit të "këshillimit dhe diskutimit paraprak brenda ose midis autoriteteve publike".<br>Në interpretim të kësaj dispozite, si edhe në praktikën vendimmarrëse dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dokumentet që pasqyrojnë diskutime të brendshme, opinione teknike, qëndrime individuale të anëtarëve, relacionet paraprake, projektaktet dhe materialet që lidhen me procesin deliberativ të autoritetit publik, konsiderohen dokumente të brendshme pune, aksesi ndaj të cilave mund të kufizohet për të garantuar funksionimin normal të procesit vendimmarrës dhe lirinë e diskutimit të organit kolegjial. | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjithashtu, referuar Ligjit nr. 124/2024 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, veçanërisht nenit 44 të tij, e drejta për akses në dokumente zyrtare ushtrohet në harmoni me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave e lirive themelore të personave fizikë.<br>Procesverbalet dhe regjistrimet audio të mbledhjeve përmbajnë të dhëna identifikuese, opinione individuale dhe diskutime të anëtarëve të organit kolegjial, të cilat përbëjnë të dhëna personale të përpunuara në kuadër të ushtrimit të funksioneve publike.<br>Në kuptim të këtij ligji, autoriteti publik ka detyrimin të realizojë balancimin ndërmjet së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe të garantojë konfidencialitetin e diskutimeve të brendshme administrative.<br>Gjithashtu, në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, projektaktet dhe dokumentet përgatitore nuk përbëjnë akte administrative përfundimtare, por materiale pune të përdorura gjatë fazës së shqyrtimit administrativ dhe formimit të vullnetit të organit kolegjial.<br>Në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, sipas të cilit *"organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, autoriteti publik ka garantuar të drejtën tuaj për informim dhe mbrojtje të interesit të ligjshëm përmes vënies në dispozicion të aktit administrativ përfundimtar, konkretisht Vendimit nr. 650, datë 30.12.2025 të KKTKM-së.<br>Akti administrativ i sipërcituar përmban shprehjen e vullnetit të organit kolegjial dhe elementet thelbësore të vendimmarrjes administrative, duke i mundësuar palës ushtrimin efektiv të të drejtave procedurale dhe ligjore që rrjedhin prej tij.<br>Për rrjedhojë, e drejta për t'u njohur me aktin administrativ përfundimtar është garantuar plotësisht, ndërsa procesverbalet, regjistrimet audio, projektaktet dhe dokumentacioni i brendshëm përgatitor mbeten dokumente të përdorura gjatë procesit deliberativ dhe nuk përbëjnë në vetvete akte administrative përfundimtare.<br>Për sa më sipër, kërkesa për vënien në dispozicion të procesverbaleve dhe dokumentacionit të brendshëm të procedurës, apo regjistrimeve audio, **nuk pranohet**. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Përsa i përket kërkesës tuaj për pajisjen me projektet e miratuara me Vendimin e KKTKM – së nr. 565, datë 20.11.2025 dhe Vendimin e KKTKM-së 650, datë 30.12.2025, ju informojmë se:<br>Në bazë të kërkesës së MTKS-së, për rivlerësimin e Vendimit nr. 565 datë 20.11.2025, KKTKM në mbledhjen e datë 30.12.2025 mori vendimin nr. 650, ku citohet:<br>1. *Miratimin e kërkesës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për rivlerësimin e Vendimit të KKTKM-së nr. 565, datë 20.11.2025, për projektin "Ndërhyrje restauruese në fasadën e objektit "Hotel Internacional në rrugën Kajo Karafili", Monument Kulture Kategoria e II-të, me aplikues dhe zhvillues _________________*<br>2. *Të vijojë faza e punimeve vetëm për ndërhyrjet restauruese në fasadën e objektit "Hotel Internacional në rrugën Kajo Karafili", Monument Kulture Kategoria e II-të;*<br>Sa më sipër KKTKM e ka përmbyllur procesin e vendimmarrjes për rivlerësimin e Vendimit 565 datë 20.11.2025, dhe për t'u pajisur me projektin e rivlerësuar, Ju duhet të depozitoni me e-mail projektin me komponentët e tij (*Relacion teknik, preventiv punimesh, grafik punimesh dhe specifikime teknike*) sipas dispozitave të VKM 1125 datë 30.12.2020, në respektim të pikës 2 të Vendimit nr. 650 datë 30.12.2025 të KKTKM-së.<br>**Në konluzion, IKTK vlerëson se është ezauruar përfundimisht shqyrtimi administrativ dhe kthimi i përgjigjes për të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana Juaj lidhur me këtë çështje, duke mos mbetur asnjë aspekt procedurial administrativ i patrajtuar nga institucioni**. | | |
| 10 | 14.05.2026 | Informacion mbi statusin e godines se Avokaturës së Shtetit është ish-Hotel Drini rruga Abdi Toptani, | | | E plotë | Jo |
| 11 | 19.05.2026 | Dorezim dokumentacioni ne vijim te aplilimebve ne e-albania (sistemi e-leje) | 21.05.2026 | Referuar pikës 7 të Kreut II/A të **VKM-së 252, datë 29.04.2022** "*Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre*", si dhe në paragrafin e dytë të nenit 5, Kreu II, të Rregullores "*Mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line për sistemin e* | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Ministrisë së Kulturës*", miratuar me **Urdhrin e Ministrit të Kulturës, nr. 463, datë 19.07.2022** citohet: Në rast se, pranë protokollit të institucionit paraqiten kërkesa për shërbim në rrugë postare në formën e dokumentit shkresor apo nëpërmjet postës elektronike, atëherë nëpunësi përgjegjës nuk e merr në trajtim atë, por kthen përgjigje kërkuesit me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke e udhëzuar mbi paraqitjen e kërkesës nëpërmjet platformës "e-albania".<br><br>Për sa me sipër, **çdo dokumentacion ne funksion te projektit, duhet te jete i depozituar ne sistemin e-leje**. | | |
| 12 | 12.06.2026 | Kerkese per informacion për objektin me status Monument Kulture 'Sahati Kompleks', Vlorë (Skeda nr. 137). | 16.06.2026 | Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar në adresën elektronike të IKTK-së, dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 27.08.2025 "Për miratimin e tarifave dhe mënyrën e përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore" (pika 5), ju përcjellim bashkëlidhur, nëpërmjet linkut përkatës, kopje digjitale të dokumentacionit arkivor qe disponohet per objektin "Sahati kompleks" në qytetin e Vlores, si me poshtë:<br>• Dokumentacion fotografik ;<br>• Projekt restaurimi viti 2017.<br>Duke Ju falenderuar per bashkepunimin,<br>https://www.transferxl.com/it/download/08n30XKgYhrM8 | E plotë | Jo |